



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.27, datë 14.12.2022

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“STRUKTURË ME FUNKSION HOTELERI 1, 2, 3 DHE 4 KAT ME 1 KAT NËNTOKË”,
ME VENDNDODHJE NË DHËRMI, BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të nenit 113, 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative, neneve 7, shkronja “ç”, 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive “Xheluks Konstruksion” sh.p.k dhe “Edon Konstruksion” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Strukturë me funksion hoteleri 1, 2, 3 dhe 4 kat me 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Dhërmi, Bashkia Himarë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “Xheluks Konstruksion” sh.p.k dhe “Edon Konstruksion” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë, bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Procedurat administrative/ligjore për objektin e përmendur në pikën 1 të këtij Vendimi, do të vijohen nga Bashkia Himarë, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në përputhje me marrëveshjen përkatëse për delegim kompetencash, bashkëlidhur këtij Vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Himarë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 22, datë 16.03.2022 “Për miratim Leje Zhvillimi për objektin: “Strukturë me funksion hoteleri”, me vendndodhje në Dhërmi, Bashkia Himarë, shfuqizohet.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE MËDIESIT

MIRELA KUMBARO PURXH



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOFA

